

**KONTRATË PËR HARTIMIN E AKTIT TË THEMELIMIT TË
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ELITE CONTRACTORS” SH.P.K.**

Sot, më datë 06.09.2023 (dy mijë e njëzetë e tre), pala e mëposhtme:

1. Znj. Entela Abazi, e bija e Sherif dhe Zyhra, lindur në datë 04.12.1990 në Tiranë e me banim në Tiranë, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse e lehtënjofimit me numër personal J06204064G

ka vendosur të nënshkruajë këtë Akt Themelimi të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **“ELITE CONTRACTORS” SHPK**, aktiviteti i së cilës rregullohet nga ky Akt Themelimi, Statuti dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.

**NENI 1
ORTAKËT THEMELUES**

1.1 Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar krijohet nga ortakët si mëposhtëm:


1. Znj. Entela Abazi, e bija e Sherif dhe Zyhra, lindur në datë 04.12.1990 në Tiranë e me banim në Tiranë, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse e lehtënjofimit me numër personal J06204064G

**NENI 2
BAZA LIGJORE**

- 2.1** Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 *“Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”* i ndryshuar, si dhe të Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 *“Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”* i ndryshuar.
- 2.2** Kjo shoqëri fiton zotësinë për të vepruar me regjistrimin e saj në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

**NENI 3
EMËRTIMI**

- 3.1** Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **“ELITE CONTRACTORS” SHPK.**



NENI 4 SELIA

- 4.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Njesia Bashkiake Nr. 9, Rruga "Asim Vokshi", pallati Albbuilding-2T, kati i 2 Tiranë.

NENI 5 OBJEKTI

- 5.1 Objekti i aktivitetit të kësaj shoqërie është:

Ndertimi i autostradave dhe i rrugëve të tjera dytësore, daljet e aeroporteve e fusha sporti. Ndertimi i objekteve me stacione pompimi, ujesjellësa e kanalizime. Ndertimi dhe ngritja e ndërtesave arkitekturore dhe veprave të artit, ndërtime civile dhe industriale. etj. Vendosja e dyshemeve, montimi i cativë të ndertimeve, importeksport i mallrave të ndryshme, etj. Shfrytëzim dhe përpunim mineralësh të ndryshme, hapje dhe shfrytëzim karriere lumore dhe malore, prodhim inertesh. Ndertimi i autostradave, rrugëve, aeroporteve dhe objekteve sportive. Zhvillimi dhe ndertimi në sektorin e energjisë, projektim, ndertim, financim, shfrytëzim i veprave të ndryshme në fushën e prodhimit të energjisë elektrike nëpërmjet veprave të ndryshme si hec, impianteve fotovoltaike, turbinave eolike etj, dhe të çdo lloji ndertimi në sektorin e energjetikës. Punime të tjera të specializuara të ndertimit, vendosja e instalimeve të kanalizimit të ndryshëm; Punime elektrike; Punime hidroteknike, punime gjeodezike, punime gjeologjike, punime dhe vlerësime të ndikimit në mjedis. Grumbullim, pastrim i mbetjeve urbane, mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme . Grumbullim, përpunim dhe shitje skrapit. Pastrimin e ambjenteve të brendshme dhe të jashtme dhe sistemit-gjelberim. Shërbime lavanderie dhe dezinfektimi, deritizimi etj. Riparim i mjeteve motorike (servis). Tregtim automjeteve, pjesëve motorike. Kryerje e seleksionit të mbetjeve të ndryshme. Mirembajtje rutine dimerore rrugësh. Prodhim, mirembajtje, riparim kazan mbeturinash, lavazh mjeteve për vete dhe të tjerë. Grumbullim dhe transportim i ujërave dhe llumrave nga pastrimi i gropave septike. Transport për vete dhe për të tjerë të mallrave e jo vetëm si dhe çdo akvitet tjetër të lejuar nga legjislacioni shqiptar.

NENI 6 KOHËZGJATJA

- 6.1 Shoqëria ka një kohëzgjatje të pacaktuar. Ajo mund të përfundojë veprimtarinë përpara këtij afati në rastet e prishjes, falimentimit ose të likuidimit të shoqërisë të parashikuara këto në legjislacionin tregtar shqiptar në fuqi..

NENI 7 KAPITALI THEMELTAR

- 7.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 000 (njëqind mijë) Lekë i ndarë në 1 (një) kuotë. Çdo kuotë njësi jep të drejtën e një vote. Kapitali themeltar i shoqërisë nënshkruhet tërësisht nga Ortaku.



7.2 Pjesët e kapitalit të shoqërisë zotërohen nga Ortaku, si më poshtë vijon:

- **Ortaku Entela Abazi**, zotëron 1 (një) kuotë, të barabartë me 100% (njëqind) të kapitalit themeltar.

NENI 8 ADMINISTRIMI

8.1 Me këtë akt emërohet Administrator i shoqërisë:

1. Znj. Entela Abazi, e bija e Sherif dhe Zyhra, lindur në datë 04.12.1990 në Tiranë e me banim në Tiranë, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse e lehtënjofimit me numër personal J06204064G

Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit, në përputhje me parashikimet e Statutit të shoqërisë dhe të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

Administratori emërohet për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë ripërtëritjeje.

NENI 9 DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

- 9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në përputhje me ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, si dhe me ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar.
- 9.2 Çështjet që nuk trajtohen në këtë Akt Themelimi, rregullohen në Statut, si dhe në legjislacionin përkatës shqiptar.
- 9.3 Ky Akt Themelimi është hartuar në Tiranë, Shqipëri, në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe, duke patur të gjitha fuqi të njëjtë ligjore.

O R T A K U

ENTE LA ABAZI

Entela Abazi
